



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 27 tetor 2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Duda Balje.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në Komision, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Artan Venhari- ZAP, Ibrahim Gylderen- ZAP, Qëndresa Mulaj- ZAP, Sanije Berisha- OSBE, Albert Krasniqi- KDI, Sylejman Blakaj- Kosova Sot, Pranvera Musa- Kosova Press, Besarta Jashari- ZPRK, Florina Merovci- ZPRK, Besa Maliqi- Kallxo.com dhe Besmir Kokollari- Instituti i CHAT.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zv. kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.10.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2014;
4. Të ndryshme.

***Zv. kryetari,** pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

***Zv. kryetari-** konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.10.2015

***Zv. kryetari-** konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20.10.2015, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2014

Zv. kryetari i jep fjalën z. Hajdar Beqa, që të prezantojë kapitullin e shtatë të Raportit Vjetor të Auditimit.

Hajdar Beqa- Kapacitetet menaxhuese të OB-ve kanë tendencë rritje dhe përmirësimi të vazhdueshëm në shumë fusha të aktiviteteve financiare dhe operative. Edhe përmbushja e kërkesave ligjore për raportim financiar është evidente. Me gjithë të arriturat, institucionet buxhetore vazhdojnë të ballafaqohen me sfida nga më të ndryshmet. Buxheti i limituar në raport me nevojat reale në nivel vendi ka pasur efektin e vet. Një analizë më e thellë e nevojave specifike të secilës OB është e nevojshme para se të përcaktohen kufijtë buxhetor. Kjo do mundësonte një shpërndarje racionale të buxhetit vendor. OB-të gjithashtu vazhdojnë të sfidohen edhe në menaxhimin e të hyrave, borxheve dhe të arkëtueshmeve, si dhe me raportimin e brendshëm. Prioritet dhe vëmendje e veçantë e menaxherëve, si nga niveli qendror, ashtu edhe nga nivel lokal, duhet t'i kushtohet investimeve kapitale. Aktivitetet menaxheriale duhet të kenë fokus të veçantë monitorimin dhe implementimin e projekteve me kohë dhe përmbushjen e planeve dhe objektivave. Funksionimi i plotë i sistemit të auditimit të brendshëm, do të shtonte

vlerë në sigurimin e cilësisë së sistemeve të MFK-së. Sfidë tjetër për trajtim është edhe mungesa e drejtorit ekzekutiv në komuna, si dhe drejtorët e emëruar politikisht.

Zv. kryetari i jep fjalën z. Naim Fetahu, që të prezantojë kapitullin e tetë të Raportit Vjetor të Auditimit.

Naim Fetahu- Në përgjithësi ka tentime për përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga organizatat e audituara. Megjithatë, ende nuk është i mjaftueshëm monitorimi dhe mbikëqyrja mbi Bordet Drejtuese nga nivelet e larta si Kuvendi. Qeveria (ose Kuvendi aty ku është e aplikueshme), nuk ka arritur të monitorojë drejtuesit/menaxhuesit e organizatave dhe të kërkojë rezultate gjatë ekzekutimit të programeve/planeve apo aktiviteteve. Aktivitetet e organizatave të audituara në përgjithësi nuk janë sa duhet efikase dhe efektive. Në disa raste strategjitë ekzistojnë, por nuk janë koordinuar me planet vjetore, si në rastin e granteve në sektorin e bujqësisë. Implementimet e programeve vjetore kanë dobësi, në përgjithësi mungon qasja drejt rezultateve dhe në shumicën e rasteve nuk i vendosin indikatorët e performancës. Kualiteti jo i mirë i të dhënave i përcjellin shumicën e organizatave dhe nuk raportohet për arritjet apo ngecjet në rezultate, kjo dukuri u vërejt sidomos në shëndetësi, sektorin e bujqësisë dhe mirëmbajtjen e automjeteve. Organet monitoruese dhe mbikëqyrëse nuk e luajnë rolin e tyre aktiv, për të identifikuar ngecjet e mundshme me qëllim për të marrë masa përmirësuese. Këto dobësi janë përhapur në të gjitha organizatat e audituara dhe si e tillë mjaft domethënëse. Çështje tjetër për trajtim, është edhe mënyra e caktimit të auditorëve të jashtëm për auditimin e Ndërmarrjeve Publike (emërimi i tyre nga vetë NP-të dhe jo nga përfaqësuesi i pronarit, si Ministria e Zhvillimit Ekonomik në emër të Qeverisë) i cili do të kishte mundësi të kërkojë një auditim më gjithëpërfshirës i lidhur me kërkesat e pronarit. Kjo vlen edhe për RTK-në. Si përfundim ka ende mjaft për të bërë me qëllim që shpenzimi i parasë publike në programet/aktivitetet qeveritare të bëhet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

Zv. kryetari pasi që nuk pati të interesuar për të diskutuar për kapitulli VII dhe VIII filloi me leximin e rekomandimeve, të cilat ishin përgatitur paraprakisht nga stafi mbështetës i komisionit. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të nenit 62 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjet e mbajtura më 20 dhe 27 tetor 2015, e shqyrtoi Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2014, me numër 05/1307/Ra-030, të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqes këto:

REKOMANDIME

I. Të miratohen Rekomandimet së bashku me Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2014, të cilat e obligojnë Qeverinë e Republikës së Kosovës si vijon:

1. Të përgatisë një raport lidhur me implementimin e rekomandimeve të auditorit për vitin 2013, të adresuara nga komisioni, me vendimin e Kuvendi nr. 05-V-60 të datës

14 maj 2015, për të cilat ende KMPF nuk ka marrë një raport të tillë. Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 31 janar 2016.

2. Ministria e Financave, të bëjë një analizë të mirëfilltë financiare duke harmonizuar nevojat reale me mundësitë aktuale buxhetore dhe gjithashtu të respektoj klasifikimet buxhetore dhe kufirin e deficitit buxhetor (kap. 3 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 31 mars 2016.
3. Të siguroj konsolidimin e transaksioneve ndërqeveritare, përmirësimin e procesit të regjistrimit të pagesave nga palët e treta dhe prezantimin e drejtë të pagesave në Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës (kap. 3 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 31 mars 2016.
4. Ministria e Financave, të themelojë një mekanizëm i cili do të analizonte shkaqet e rritjes së obligimeve nga viti në vit nëpër organizata buxhetore, me qëllim që obligimet e papaguara të zvogëlohen në minimum (kap. 3 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 31 mars 2016.
5. Të sigurojë që faturat e furnitorëve menaxhohen me kujdesin e shtuar dhe ato paguhen me kohë për të evituar rrethanat të cilat mund shkaktojnë pagesën e tyre drejtpërdrejt nga MF (kap. 3 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 31 mars 2016.
6. Të udhëheqë dhe të koordinojë zhvillimin e një plani veprues për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm dhe të raportojë për progresin e arritur (kap. 4 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 31 janar 2016.
7. Të hartojë aktet ligjore për të mundësuar futjen në funksion të një menaxheri ekzekutiv në komuna si nëpunës më i lartë civil, përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të përditshme dhe shërbimeve për qytetarët (kap. 4 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 30 qershor 2016.
8. Të vazhdojë me reformat në shërbimin civil dhe në funksionalizimin e sistemit të ri të pagave në afatin sa më të shkurtë (kap. 5 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 30 qershor 2016.
9. Të zbatojë një proces efektiv të menaxhimit të automjeteve në të gjitha organizatat buxhetore, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm dhe veprim me kohë ndaj faktorëve dhe barrierave ekzistuese që pengojnë zbatimin e kërkesave ligjore (kap. 5 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 31 mars 2016.
10. Ministria e Financave, të vazhdojë zhvillimin e Prokurimeve Qendrore për artikujt e konsumit të përbashkët (kap. 6 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 31 mars 2016.
11. Ministria e Financave, duhet të ngritë efikasitetin në inkasimin e të hyrave dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve sipas planit, në mënyrë që të mbështesin projeksionet

në nivel të përgjithshëm buxhetor (kap. 7 RVA). Një raport me veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantohet Kuvendit deri më 30 qershor 2016.

Hajdar Beqa- Ne në nivel komisioni, sekretarie dhe ekspertëve i kemi shqyrtuar këto rekomandime, mendoj që 11 rekomandimet e kanë vlerën dhe peshën e tyre që të kemi një menaxhim më efikas të parasë publike. Çështje tjetër gjithashtu është edhe mënyra e zgjedhjes apo caktimit të auditorëve të jashtëm për ndërmarrjet publike. Komitetin e Auditimit e cakton Ministria, paraprakisht e ka zgjedh Ministria e Financave, Komitetet e Auditimit i emëron aksionari, ku i nënshkruan vendimet ministri i Zhvillimit Ekonomik, kjo kryhet në nivel qeverie. Prandaj unë mendoj që në bashkëpunim me ju, të fusim edhe rekomandimin e dymbëdhjetë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik të shqyrtojë bazën ligjore, më qëllim që auditorët e jashtëm për ndërmarrjet publike përfshirë edhe RTK- në, procedura e zgjedhjes të bëhet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe jo nga ndërmarrjet publike. Të shikojmë se nëse ndërmarrja e hap tenderin për auditorë të jashtëm, për 3 vjet me mundësi vazhdimi. Mendoj që është më i pavarur nëse aksionari e kryen këtë punë, të shikojmë edhe mundësinë ligjore dhe kjo kompetencë ligjorisht t'i bartet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ku në atë ministri është edhe Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, dhe në ndërmarrjet publike në Kosovë, sidomos në ndërmarrjet qendrore është aksionare Qeveria. Për këtë çështje mendoj që Ministria e Zhvillimit Ekonomik për veprimet e ndërmarra duhet t'i prezantojë Kuvendit deri më 30 qershor 2016.

Zv. kryetari- Mendoj që Ministria për Zhvillim Ekonomik, do të duhet të jetë ajo që e udhëheq krejt procesin e auditimit të ndërmarrjeve publike, paraprakisht vendimin duhet ta merr në nivel Qeverie. Qeveria nëpërmes Ministrisë për Zhvillim Ekonomik t'i caktojë bordet.

Hajdar Beqa- Aktualisht Qeveria përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, i monitoron Ndërmarrjet Publike, por është Komuniteti i Ministrave që përbëhet prej pesë ministrave, ku ministri i Zhvillimit Ekonomik i raporton Komunitetit, Komuniteti i raporton Qeverisë, por ne po flasim në këtë rast të kemi rekomandimin vetëm për një çështje, për përzgjedhjen e auditorëve të jashtëm, që kanë obligim ligjor në bazë ligjit të ndërmarrjeve publike, ku secila ndërmarrje publike duhet të ketë auditim të jashtëm. Komuniteti i Auditimit që është i caktuar nga aksionari është çështje tjetër, Auditori i Brendshëm në kompani është prapë çështje tjetër, auditimet e auditorit të përgjithshëm është prapë çështje tjetër, por është edhe një obligim ligjor të ndërmarrjet publike që të kenë edhe auditim të jashtëm. Te auditimi i jashtëm mendova që rekomandimi të jetë vetëm të përzgjedhja.

Zv.kryetari i jep fjalën përfaqësuesit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm z. Artan Venhari.

Artan Venhari- Ajo që u përmend është kapitulli i tetë, merret veçanërisht me monitorimin dhe mbikëqyrjen. Mangësia e cila u vërejt te ndërmarrjet publike të nivelit qendror, është mbikëqyrja e jashtme apo mungesa e saj. Sistemi deri tani është se Ministria e Zhvillimit Ekonomik vetëm u jep dritën e gjelbër ndërmarrjeve publike që të hyjnë në përzgjedhjen e auditorëve të jashtëm, por pronare e ndërmarrjeve publike, si të nivelit qendror, ashtu edhe të nivelit lokal është Qeveria. Prandaj Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka obligime në emër të Qeverisë dhe nën mbikëqyrjen e tyre dhe raporti i ndërmarrjeve publike duhet të bazohet në një performancë të atyre ndërmarrjeve, ndërsa raportet e auditimit të jashtëm i marrin ndërmarrjet, mirëpo nuk janë kërkesë e Qeverisë apo e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në këtë rast. Mendoj që ky do të ishte një rekomandim shumë i duhur dhe shumë pozitiv.

Hajdar Beqa- Të shikohet baza ligjore edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe deri në qershor të vitit 2016 t'i raportojë Kuvendit, apo eventualisht edhe Komisionit, se a është standard i dyfishtë apo jo. Ne nuk po duam që me i shfuqizuar Komitetet e Auditimit që janë të emëruar nga Qeveria, por mendoj që të ketë një auditim më gjithëpërfshirës, jo me i caktuar kriteret, por menduam vetëm për procedurat e auditimit, është më i pavarur një auditor nëse zgjidhet prej ministrisë se sa të zgjidhet prej ndërmarrjes.

Synavere Rysha- Problematikë tani për tani janë menaxhimi dhe udhëheqja e ndërmarrjeve publike në Kosovë dhe i vetmi organ që i nxjerr në pah të metat është auditori. Mendoj që kjo është shumë e drejtë dhe me vend, vetëm se duhet të shihet se a është në përputhje me rregulloret dhe ligjin. Sidoqoftë unë jam për rekomandimin, sepse është shumë me rëndësi se kush e përzgjedh auditorin e jashtëm që ta bëjë auditimin e kompanisë. Duke e pasur mundësinë kompania vetë me e zgjedh, mendoj që aty paraprakisht mundet me u negociuar, aq më mirë nëse e zgjedh për një periudhë më të gjatë trivjeçare, kjo në asnjë mënyrë nuk guxon të mbetet, është gabim nëse është me ligj, por sidoqoftë ne duhet ta formulojmë rekomandimin në këtë formë, nëse nuk është e rregulluar me ligj, atëherë brenda gjashtë muajve të intervenohet brenda ligjit për ndërmarrjet publike.

Naim Fetahu- Mendoj që propozimi është me vend, është konflikt interesi që me e zgjedh vetë ndërmarrja auditorin e jashtëm për auditimin e PVF-ve të ndërmarrjeve. Nëse kemi pengesa ligjore në këtë çështje, nëse dikush duhet të ndryshoj ligjet, mendoj se jemi ne ata të cilët duhet të iniciojmë procedurat.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike vendosi që Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2014 të adresohet për seancë plenare bashkë me rekomandimet e KMFP.

4. Të ndryshme

Zv. kryetari kërkoi nga administrata e komisionit të hartojë një listë me raportet individuale të auditimit, me qëllim që komisioni në mbledhjen e radhës të vendosë se cilat nga këto do t'i shqyrtojë, për shkak që janë shumë raporte të cilat kanë ardhur në KMFP. Me këtë e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi